



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

PROJEKTLIGJI PËR TEKSTE SHKOLLORE¹

DRAFT LAW ON TEXTBOOKS²

NACRT ZAKONA O ŠKOLSKIM UDŽBENICIMA³

¹ Projektligji për tekste shkollore, është aprovuar në mbledhjen e 116 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin nr. 35/116, datë 28.12.2022.

² Draft Law on textbooks, was approved on the 116th meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No.35/116 dated 28.12.2022

³ Nacrt Zakona o školskim udžbenicima, usvojen je na 116 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br.35/116, datum 28.12.2022.

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p>LIGJ PËR TEKSTE SHKOLLORE</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Ky ligj ka për qëllim:</p> <p>1.1. Përcaktimin e normave, standardeve dhe procedurave themelore për hartimin, vlerësimin dhe botimin e teksteve shkollore, materialeve mësimore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në arsimin parauniversitar;</p> <p>1.2. Përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të Ministrisë përkatëse për Arsim, në tekstin e mëtejshëm “Ministria”, dhe palëve të tjera sipas përcaktimeve me këtë ligj;</p>	<p>Assembly of the Republic of Kosova,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova,</p> <p>Approves:</p> <p>LAW ON TEXTBOOKS</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 The purpose</p> <p>1. This has for purpose:</p> <p>1.1. Determining the norms, standards and basic procedures for drafting, evaluating and publishing textbooks, teaching materials, teaching aids, school reading book and pedagogical documentation in Pre-University Education;</p> <p>1.2. Defining the duties and responsibilities of the respective Ministry for Education hereinafter "the Ministry", and other parties as defined by this law;</p>	<p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p>ZAKON O ŠKOLSKIM UDŽBENICIMA</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>1. Ovaj zakon ima za cilj:</p> <p>1.1. Utvrđivanje normi, standarda i osnovnih procedura za izradu, vrednovanje i objavljivanje školskih udžbenika, nastavnog materijala, nastavna sredstava, školske lektire i pedagoške dokumentacije u preduniverzitetskom obrazovanju;</p> <p>1.2. Definisanje dužnosti i odgovornosti Ministarstva obrazovanja u daljem tekstu: "Ministarstvo", i drugih strana definisanim ovim zakonom;</p>
--	--	--

<p>1.3. Krijimin e kushteve për konkurrencë të lirë, transparencë, llogaridhënie dhe ndalimin e konfliktit të interesit për hartimin, vlerësimin dhe botimin e teksteve shkollore, materialeve mësimore, mjeteve shkollore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në arsimin parauniversitar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet</p> <p>1. Përkufizimet e këtij Ligji janë si në vijim:</p> <p>1.1. “Struktura përgjegjëse e ministrisë për botimin e teksteve shkollore” – është struktura kryesore përgjegjëse për planifikimin dhe botimin e teksteve shkollore, materialeve mësimore, mjeteve shkollore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në arsimin parauniversitar;</p> <p>1.2. “Teksti shkollor”, për arsimin parauniversitar është mjet mësimor themelor në formë të librit të shtypur, i hartuar në përputhje me dokumentet kurrikulare shtetërore dhe standardet për tekste shkollore, i miratuar nga Ministria dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave përkatëse të nxënësve;</p>	<p>1.3. Creating conditions for free competition, transparency, accountability and prevention of conflict of interest for the drafting, evaluation and publication of textbooks, teaching materials, school supplies, school reading book and pedagogical documentation in Pre-University Education.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p> <p>1. The definitions of this Law are as follows:</p> <p>1.1. “The responsible structure of the ministry for the publication of school textbooks” - is the main structure responsible for planning and publishing textbooks, teaching materials, school supplies, school reading book and pedagogical documentation in Pre-University Education.</p> <p>1.2. "Textbook" for pre-university education is a basic teaching tool in the form of a printed book, drafted in accordance with state curricular documents and standards for textbooks, approved by the Ministry and in order to develop the relevant competencies of students;</p>	<p>1.3. Stvaranje uslova za slobodnu konkurenciju, transparentnost, odgovornost i sprečavanje sukoba interesa za izradu, procenu i objavljivanje školskih udžbenika, nastavnog materijala, školskog pribora, školske lektire i pedagoške dokumentacije u preduniverzitetskom obrazovanju.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p> <p>1. Definicije ovog Zakona su sledeće:</p> <p>1.1. “Struktura odgovorna za objavljivanje školskih udžbenika u ministarstvu” - je glavna odgovorna struktura za planiranje i objavljivanje školskih udžbenika, nastavnog materijala, školskog pribora, školske lektire i pedagoške dokumentacije u preduniverzitetskom obrazovanju.</p> <p>1.2. „Školski udžbenik” za preduniverzitetsko obrazovanje je osnovno nastavno sredstvo u vidu štampane knjige, izrađen u skladu sa državnim kurikularnim dokumentima i standardima za školske udžbenike, koje odobrava Ministarstvo, a u cilju razvoja relevantnih kompetencija;</p>
--	--	--

<p>1.3. “Teksti shkollor digjital”, është mjet mësimor themelor në formë digjitale, i hartuar në përputhje me dokumentet kurrikulare shtetërore dhe standardet për tekste shkollore, i miratuar nga Ministria dhe përfshin të gjitha elementet që përmban përkufizimi për “tekstin shkollor”, por nuk kufizohet vetëm me to. Teksti digjital, përveç përmbajtjeve të zakonshme të njëjësive mësimore, në përputhje me specifikat e lëndës ose fushës ka edhe materiale mësimore tekstuale dhe audio-vizuale, aparaturë didaktike interaktive, laborator virtual, lojëra edukative për nxënësit, mundësi vlerësimi nga mësimdhënësit dhe mundësi vetëvlerësimi për nxënësit, mundësi që mësimdhënësi të shtojë materiale shpesh, mundësi lidhjeje me burime të ndryshme të platformave online, mundësi lidhjeje me pajisjet teknologjike të mësimdhënësit dhe me pajisjet teknologjike në klasë;</p> <p>1.4. “Materialet mësimore themelore”, janë materiale të miratuara nga Ministria, të shtypura ose digjitale, të cilat përmbajnë elementet e tekstit shkollor, e kryejnë funksionin e tekstit shkollor dhe mund të përdoren si zëvendësim për tekstin shkollor. Këto materiale mund të përdoren në të gjitha institucionet edukativo-arsimore kur përgatitja e një teksti të vetëm nuk është e mundur.</p>	<p>1.3. "Digital textbook" is a basic teaching tool in digital form, designed in accordance with state curriculum documents and standards for textbooks, approved by the Ministry and including all the elements contained in the definition of "textbook", but not limited to them. The digital text, in addition to the usual contents of the teaching units, in accordance with the specifics of the subject or field also has textual and audio-visual teaching materials, interactive didactic apparatus, virtual laboratory, educational games for students, evaluation opportunities by teachers and self-assessment opportunities for students, the opportunity for the teacher to add additional materials, the ability to connect to various online platform resources, the ability to connect to the teacher's technology equipment and technology equipment in the classroom;</p> <p>1.4. "Basic teaching materials" are materials approved by the Ministry, printed or digital, which contain the elements of the textbook, perform the function of the textbook and can be used as a substitute for the textbook. These materials can be used in all upbringing-educational institutions when the preparation of a single text is not possible.</p>	<p>1.3. „Digitalni školski udžbenik“ je osnovno nastavno sredstvo u digitalnom obliku, osmišljeno u skladu sa državnim kurikulumskim dokumentima i standardima za školske udžbenike, koje je odobrilo Ministarstvo i koje obuhvata sve elemente sadržane u definiciji za „školski udžbenik“, ali nije ograničeno samo na to. Digitalni udžbenik, pored uobičajenih sadržaja nastavnih jedinica, u skladu sa specifičnostima predmeta ili oblasti ima i tekstualne i audio Samo vrenovanje nastavne materijale, interaktivnu didaktičku aparaturu, virtuelnu laboratoriju, edukativne igre za učenike, mogućnosti ocenjivanja od strane nastavnika i mogućnosti samoocenjivanja za učenike, mogućnost da nastavnik doda dodatne materijale, mogućnost povezivanja sa različitim resursima onlajn platforme, mogućnost povezivanja sa tehnološkom opremom nastavnika i tehnološkom opremom u učionici;</p> <p>1.4. „Osnovni nastavni materijali“ su materijali odobreni od strane Ministarstva, štampani ili digitalni, koji sadrže elemente školskog udžbenika, obavljaju funkciju školskog udžbenika i mogu se koristiti kao zamena za školski udžbenik. Ovi materijali se mogu koristiti u svim edukativni-obrazovnim institucijama tamo gde je priprema jednog teksta nemoguće.</p>
---	---	---

<p>1.5. “Materialet mësimore plotësuese”, janë materiale shtesë për procesin mësimor, të shtypura ose digjitale, të cilat ndihmojnë arritjen e rezultateve të përcaktuara në kurrikulat lëndore/programe mësimore apo modulet. Për përdorim në nivel vendi, këto materiale duhet të miratohen nga Ministria;</p> <p>1.6. “Mjete shkollore”, janë mjete pedagogjike në formë të pajisjeve, veglave dhe materialeve të ndryshme didaktike e teknike që përkrahin arritjen e kompetencave kurrikulare tek nxënësit. Mjetet shkollore përdoren edhe në punën edukativo-arsimore në institucionin parashkollor, qendra burimore dhe shkolla për edukimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;</p> <p>1.7. “Libri i mësimdhënësit”, është një udhëzues praktik për mësimdhënësit në përdorim të tekstit shkollor, që ofron udhëzime pedagogjike dhe metodologjike në realizimin e përmbajtjeve mësimore në tekst shkollor, përfshirë këtu dhe jo të kufizuar vetëm në: udhëzime për vlerësim të nxënësve për njësi mësimore dhe referenca për burime dhe materiale shtesë për njësitë mësimore të tekstit shkollor;</p>	<p>1.5. “Supplementary teaching materials” are additional materials for the teaching process, printed or digital, which help to achieve the results defined in the subject curricula / teaching programs or modules. For use at the national level, these materials must be approved by the Ministry;</p> <p>1.6. "School tools" are pedagogical tools in the form of equipment, tools and various didactic and technical materials that support the achievement of curricular competencies in students. School tools are also used in upbringing-educational work in preschool institutions, resource centers and schools for the education of students with special educational needs;</p> <p>1.7. The "Teacher's Book" is a practical guide for teachers using the textbook, which provides pedagogical and methodological instructions in the implementation of the teaching content in the textbook, including, but not limited to: instructions for evaluating students for teaching units ; and references to additional resources and materials for the teaching units of the textbook;</p>	<p>1.5. „Dopunski nastavni materijali” su dodatni materijali za nastavni proces, štampani ili digitalni, koji pomažu u postizanju rezultata definisanih u predmetnim kurikulumima/ nastavne programe ili modulima. Za upotrebu na nacionalnom nivou, ovi materijali moraju biti odobreni od strane Ministarstva;</p> <p>1.6. „Školski alati” su pedagoška sredstva u vidu opreme, sredstava i raznih didaktičkih i tehničkih materijala koji podržavaju ostvarivanje kurikularnih kompetencija kod učenika. Školski alati koriste se i u edukativno-obrazovnom radu u predškolskim ustanovama, resursnim centrima i školama za obrazovanje učenika sa posebnim obrazovnim potrebama;</p> <p>1.7. „Knjiga za nastavnike“ je praktičan vodič za nastavnike za upotrebu školskih udžbenika, koja daje pedagoška i metodička uputstva u realizaciji nastavnog sadržaja u školskom udžbeniku, uključujući ovde, i ne ograničavajući se na: uputstva za ocenjivanje učenika za nastavne jedinice; i referenca na dodatne resurse i materijale za nastavne jedinice i školske udžbenike;</p>
---	--	--

<p>1.8. “Standarde për tekste shkollore dhe materiale mësimore”, të shtypura ose digjitale, paraqesin kriteret dhe kushtet që përcaktojnë përmbajtjen, kërkesat kurrikulare, kërkesat pedagogjike dhe psikologjike, kërkesat gjuhësore, kërkesat për barazi dhe gjithëpërfshirje, si dhe kërkesat për përpunimin teknik, didaktik dhe metodik të një teksti shkollor dhe materiali mësimor;</p> <p>1.9. “Lektyra shkollore”, përfshin libra të shtypur ose digjital të cilët mund të lexohen nga nxënësit brenda vitit shkollor në përputhje me kurrikulën përkatëse dhe katalogun e miratuar nga Ministria;</p> <p>1.10. “Dorëshkrimi”, është version origjinal i krijimit të një autori/grupi autorësh, i dorëzuar në Ministri në formë të shkruar, digjitale ose të shtypur, për vlerësim dhe miratim si tekst shkollor;</p> <p>1.11. “Këshilli Shtetëror për Tekste Shkollore”, është organ këshillëdhënës dhe mbikëqyrës i procesit të vlerësimit dhe botimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore, i përbërë nga ekspertë dhe punonjës shkencor të dalluar në kuadër të fushave të ndryshme profesionale, të emëruar me vendim të veçantë, me propozim nga Ministria dhe të miratuar nga Qeveria;</p>	<p>1.8. "Standards for textbooks and teaching materials", printed or digital, present the criteria and conditions that determine the content, curriculum requirements, pedagogical and psychological requirements, language requirements, requirements for equality and inclusiveness, as well as requirements for technical, didactic and methodology of a textbook and teaching material;</p> <p>1.9. "School reading book", include printed or digital books that can be read by students within the school year in accordance with the relevant curriculum and the catalog approved by the Ministry;</p> <p>1.10. "Manuscript" , is the original version of the creation of an author/group of authors, submitted to the Ministry in written, digital or printed form, for evaluation and approval as a textbook;</p> <p>1.11. "State Council for Textbooks", is an advisory and supervisory body of the process of evaluation and publication of school textbooks and teaching materials, consisting of experts and distinguished scientific workers in various professional fields, appointed by special decision, with proposal by the Ministry and approved by the Government;</p>	<p>1.8. „Standardi za školske udžbenike i nastavne materijale“, štampane ili digitalne, predstavljaju kriterijume i uslove koji određuju sadržaj, kurikularne, pedagoške i psihološke zahteve, jezičke zahteve, zahteve za ravnopravnost i svu inkluziju, kao i uslove za tehničku, didaktičku i metodiku obradu školskog udžbenika i nastavnog materijala;</p> <p>1.9. „Školska lektira“, obuhvata knjige štampane ili digitalne koje učenici moraju da čitaju u toku školske godine u skladu sa odgovarajućim kurikulumom i katalogom odobrenim od strane Ministarstva;</p> <p>1.10. „Rukopis“ , je originalna verzija kreacije autora/grupe autora dostavljena Ministarstvu u pisanoj, digitalnoj ili stapanoj formi, za ocenjivanje i odobravanje kao školski udžbenik;</p> <p>1.11. „Državni savet za školski udžbenici“, je savetodavno i nadzorno telo za proces vrednovanja i izdavanja školskih udžbenika i nastavnog materijala, koje čine stručnjaci i ugledni naučni radnici različitih stručnih oblasti, imenovani posebnom odlukom, na predlog Ministarstva. a odobrava Vlada;</p>
---	--	--

<p>1.12. “Dokumentacioni pedagogjik”, i shtypur ose digjital, është dokumentacioni të cilin institucioni edukativo-arsimor është i obliguar ta përdorë në pajtim me aktet ligjore dhe përfshin tërësinë e dokumenteve pedagogjike dhe administrative të domosdoshme për arsimin parauniversitar;</p> <p>1.13. “Autori”, është personi fizik që krijon një tekst shkollor, material mësimor a mjet shkollor që botohet në formë të shtypur apo digjitale;</p> <p>1.14. “Recensionimi”, është procedurë e vlerësimit me shkrim të një dorëshkrimi për një tekst shkollor, material mësimor a mjet shkollor në përputhje me standardet përkatëse;</p> <p>1.15. “Certifikimi i recensentëve”, nënkupton ndjekjen dhe kalimin me sukses të programit të ngritjes së kapaciteteve për recensentë;</p> <p>1.16. “Përgatitja teknike për botim”, nënkupton procesin e përgatitjes teknike, gjuhësore, grafike, artistike e vizuale të dorëshkrimeve të miratuara për botim nga Ministria;</p> <p>1.17. “Shtypja dhe shpërndarja”, nënkupton procesin e shtypjes dhe</p>	<p>1.12. "Pedagogical documentation", printed or digital, is the documentation which the educational institution is obliged to use in accordance with legal acts and includes all the pedagogical and administrative documents necessary for pre-university education;</p> <p>1.13. "Author" is the physical person who creates a textbook, teaching material or school tool that is published in printed or digital form;</p> <p>1.14. "Review", is a procedure of written evaluation of a manuscript for a textbook, teaching material or school tool in accordance with relevant standards;</p> <p>1.15. "Certification of reviewers", means pursuing and passing successfully the capacity building program for reviewers;</p> <p>1.16. "Technical preparation for publication" means the process of technical, linguistic, graphic, artistic and visual preparation of manuscripts approved for publication by the Ministry;</p> <p>1.17. "Printing and distribution" means the process of printing and distributing</p>	<p>1.12. „Pedagoška dokumentacija”, štampana ili digitalna, je dokumentacija koju je edukativno-obrazovna institucija dužna da koristi u skladu sa zakonskim aktima i obuhvata sve pedagoške i administrativne dokumente neophodne za preduniverzitetsko obrazovanje;</p> <p>1.13. „Autor“ je fizičko lice koje sastavlja udžbenik, nastavni materijal ili školska sredstva koje se objavljuje u štampanom ili digitalnom obliku;</p> <p>1.14. „Recenzija“ je procedura pismene procene rukopisa za školski udžbenik, Lekcija materijal ili školskog pribora u skladu sa relevantnim standardima;</p> <p>1.15. „Sertifikacija recenzenata“ podrazumeva uspešno sprovođenje i završetak programa izgradnje kapaciteta za recenzente;</p> <p>1.16. "Tehnička priprema za objavljivanje" podrazumeva proces tehničke, jezičke, grafičke, umetničke i vizuelne pripreme rukopisa odobrenih za objavljivanje od strane Ministarstva;</p> <p>1.17. „Štampanje i distribucija“ je proces štampanja i distribucije školskih</p>
---	---	---

<p>shpërndarjes së teksteve shkollore, materialeve mësimore, mjeteve shkollore, lektyrën shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik, i realizuar nga personi juridik i përzgjedhur me procedurë konkurruese dhe transparente nga Ministria;</p> <p>1.18. “ISBN-ja”, është identifikues unik numerik i librit, të shtypur apo digjital, sipas formatit të përcaktuar nga agjencia ndërkombëtare e ISBN;</p> <p>1.19. “Konflikti i interesit”, është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit dhe palëve të përfshira, kur ai/ajo ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik;</p> <p>1.20. “Plani i botimit”, është dokumenti kryesor, i përgatitur dhe azhurnuar në bazë vjetore nga Ministria, me të cilin planifikohet dhe menaxhohet procesi i përgatitjes, vlerësimit, përzgjedhjes, botimit, rishikimit, ribotimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të teksteve shkollore, materialeve mësimore, mjeteve shkollore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik në arsimin parauniversitar;</p>	<p>school textbooks, teaching materials, school tools, school reading books and pedagogical documentation, carried out by the legal entity selected through a competitive and transparent procedure by the Ministry;</p> <p>1.18. "ISBN" , is a unique numeric identifier of the book, printed or digital, according to the format defined by the international agency ISBN;</p> <p>1.19. "Conflict of interest," is the state of disagreement between the public duty and the private interests of the official, when he /she has direct or indirect private, personal or financial interests, which affect, may affect or appear to affect the its legality, transparency, objectivity and impartiality during the exercise of public function;</p> <p>1.20. "Publishing plan," is the main document, prepared and updated on an annual basis, which plans and manages the process of preparation, publication, review, reprint and continuous improvement of textbooks, teaching materials, school tools, school reading books and pedagogical documentation in Pre-University Education;</p>	<p>udžbenika, nastavnog materijala, školskog pribora, školske lektire i pedagoške dokumentacije, koji sprovodi pravno lice koje je po konkursnoj i transparentnoj proceduri izabralo Ministarstvo;</p> <p>1.18. „ISBN“ je jedinstveni numerički identifikator knjige, štampani ili digitalni, prema formatu koji definiše ISBN međunarodne agencije;</p> <p>1.19. „Sukob interesa“ je stanje neslaganja između javne dužnosti i privatnih interesa službenika i uključene strane, kada on/ona ima direktne ili indirektne privatne interese, lične ili imovinske, koji utiču, mogu uticati ili izgleda da utiču na zakonitost, transparentnost, objektivnost i njegovu nepristrasnost u vršenju javne funkcije;</p> <p>1.20. „Izdavački plan“ je glavni dokument kojeg ministarstvo priprema i ažurira na godišnjoj osnovi, kojim se planira i menadžira proces pripreme, ocenjivanje, odabira, preštampanje pregled, ponovnog štampanja i kontinuirano poboljšanje školskih udžbenika, nastavnog materijala, školskog pribora, školske lektire i pedagoške dokumentacije u preduniverzitetskom obrazovanju,</p>
---	---	---

<p>1.21. “Katalogu”, është dokument zyrtar i Ministrisë, i azhurnuar çdo vit shkollor, në të cilin publikohet lista e teksteve shkollore, materialeve mësimore dhe lektyrës shkollore të miratuara për përdorim në institucione arsimore.</p>	<p>1.21.The "Catalogues" is an official document of the Ministry, updated every school year, in which the list of textbooks, teaching materials and school reading books approved for use in the educational institutions.</p>	<p>1.21. „Katalog“ je zvanični dokument Ministarstva, koji se ažurira svake školske godine, u kome se objavljuje spisak školskih udžbenika, nastavnog materijala i školske lektire odobrenih za upotrebu u institucijama obrazovanja.</p>
<p>KAPITULLI II</p>	<p>CHAPTER II</p>	<p>POGLAVLJE II</p>
<p>KLASIFIKIMI DHE PËRDORIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE</p>	<p>CLASSIFICATION AND USE OF TEXTBOOKS</p>	<p>KLASIFIKACIJA I UPOTREBA ŠKOLSKIH UDŽBENIKA</p>
<p>Neni 3 Tekstet shkollore</p>	<p>Article 3 Textbooks</p>	<p>Član 3 Školski udžbenici</p>
<p>1. Tekstet shkollore që botohen sipas procedurave dhe përcaktimeve me këtë ligj janë:</p> <p>1.1. Tekstet shkollore të lëndëve të ndryshme në kuadër të një fushe kurrikulare, shkalle kurrikulare dhe klase, sipas niveleve formale të arsimit;</p> <p>1.2. Tekstet shkollore për lëndë profesionale për shkolla profesionale dhe të artit;</p> <p>1.3. Tekstet shkollore për komunitetet joshumicë;</p>	<p>1.Textbooks that are published according to the procedures and definitions with this law are:</p> <p>1.1. Textbooks of different subjects within a curricular area, curricular level and class, according to the formal levels of education;</p> <p>1.2. Textbooks for professional subjects for vocational and art schools;</p> <p>1.3. Textbooks for non-majority communities;</p>	<p>1. Školski udžbenici koji se objavljuju prema procedurama i definicijama sa ovim zakonom su:</p> <p>1.1. Školski udžbenici različitih predmeta u okviru kurikularne oblasti, kurikularnog nivoa i razreda, prema formalnim nivoima;</p> <p>1.2. Školski udžbenici za stručni predmeti za profesionalne i umetničke škole;</p> <p>1.3. Školski udžbenici za nevećinske zajednice;</p>

<p>1.4. Tekstet shkollore për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë;</p> <p>1.5. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore për nxënës me nevoja të veçanta të adaptuara sipas standardeve të paracaktuara nga Ministria.</p> <p>2. Teksti shkollor përbëhet nga teksti për nxënësin dhe libri i mësimit.</p> <p>3. Tekstet shkollore të miratuara nga Ministria duhet të jenë të qasshme edhe në formatin elektronik.</p>	<p>1.4. Textbooks for learning of Albanian language and Albanian culture in diaspora and exile;</p> <p>1.5. Textbooks and teaching materials for students with special needs adapted according to the standards set by the Ministry.</p> <p>2. Textbook is consisted of the student's text and the teacher's book.</p> <p>3. Textbooks approved by the Ministry should also be available in electronic format.</p>	<p>1.4. Školski udžbenici za nastavu albanskog jezika i kulture u dijaspori i;</p> <p>1.5. Školski udžbenici i nastavni materijali za učenike sa posebnim potrebama prilagođeni standardima utvrđenim od strane Ministarstva.</p> <p>2. Udžbenik se sastoji od teksta za učenike i knjiga za nastavnike.</p> <p>3. Školski udžbenici koje odobrava Ministarstvo treba da budu dostupni i u elektronskom formatu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Materialet mësimore</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Teaching materials</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Nastavni materijal</p>
<p>1. Materialet mësimore janë:</p> <p>1.1. Materiale mësimore themelore;</p> <p>1.2. Materiale mësimore plotësuese.</p> <p>2. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për tekstin shkollor që janë të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore, janë të zbatueshme përshtatshëmrisht edhe për vlerësimin, përzgjedhjen, botimin dhe përdorimin e materialeve mësimore themelore dhe materialeve mësimore plotësuese.</p>	<p>1. Teaching materials are:</p> <p>1.1. Basic teaching materials;</p> <p>1.2. Additional teaching materials;</p> <p>2. All rules, procedures and standards for the textbook that are defined by this law and sub-legal acts, are equally applicable to the evaluation, selection, publication and use of basic teaching materials and supplementary teaching materials.</p>	<p>1. Nastavni materijali su:</p> <p>1.1. Osnovni nastavni materijali;</p> <p>1.2. Dopunski nastavni materijali.</p> <p>2. Sva pravila, procedure i standardi za školske udžbenike koji su definisani ovim zakonom i podzakonskim aktima, su primenjivi i za procenu, izdavanje i upotrebu osnovnog nastavnog materijala i dopunskog nastavnog materijala.</p>

<p>3. Materialet mësimore mund të jenë në formë të shtypur ose digjitale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Tekstet shkollore për komunitetet joshumicë</p> <p>1. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore për lëndët nacionale të komuniteteve joshumicë, kalojnë në të njëjtat procedura të vlerësimit, përzgjedhjes dhe botimit të përcaktuara në këtë ligj.</p> <p>2. Për tekstet e lëndëve të përgjithshme të komuniteteve joshumicë, përkthimi dhe përshtatja bëhet përmes ftesës publike për përkthim profesional pas pranimit të vendimit për botim të teksteve të miratuara në gjuhën shqipe.</p> <p>3. Ministria i zbaton të gjitha procedurat dhe merr obligim financiar për botimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore të lëndëve nacionale për komunitetet joshumicë për arsimin e obligueshëm.</p> <p>4. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore për komunitetet joshumicë të miratuara me vendim të ministrit/es për përdorim, përfshihen në katalogun e teksteve shkollore.</p>	<p>3. Teaching materials can be in printed or digital form.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Textbooks for non-majority communities</p> <p>1. Textbooks and teaching materials for national subjects of non-majority communities go through the same evaluation, selection and publication procedures as defined in this law.</p> <p>2. For textbooks for general subjects of non-majority communities, translation and adaptation is done through a public invitation for professional translation after receiving the decision to publish approved texts in the Albanian language.</p> <p>3. The Ministry implements all the procedures and takes financial obligation for the publication of textbooks and teaching materials of national subjects for non-majority communities for compulsory education.</p> <p>4. Textbooks and teaching materials for non-majority communities approved by the Minister's decision for use are included in the textbook catalog.</p>	<p>3. Nastavni materijali mogu biti u štampanom ili digitalnom obliku.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Školski udžbenici za nevećinske zajednice</p> <p>1. Školski udžbenici i nastavni materijali za nacionalne predmete nevećinskih zajednica prolaze kroz iste procedure ocenjivanja, odabir i štampanje definisano ovim zakonom.</p> <p>2. Za udžbenike za opšte predmete iz nevećinskih zajednica, prevod i adaptacija se vrši putem javnog poziva za stručno prevođenje nakon dobijanja odluke za objavljivanje odobrenih udžbenika na albanskom jeziku.</p> <p>3. Ministarstvo sprovodi sve procedure i dobija finansijsku obavezu za izdavanje školskih udžbenika i nastavnog materijala iz nacionalnih predmeta za nevećinske zajednice za obavezno obrazovanje.</p> <p>4. Školski udžbenici i nastavni materijali za nevećinske zajednice odobreni odlukom ministra/ke za upotrebu, nalaze se u katalogu školskih udžbenika.</p>
---	--	--

<p>5. Tekstet shkollore për komunitetet joshumicë përfshijnë edhe tekstet për gjuhën shqipe dhe gjuhët e mjedisit si lëndë zgjedhore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p style="text-align: center;">Tekstet shkollore dhe materialet mësimore për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë</p> <p>1. Ministria shpall konkurs për hartimin e teksteve shkollore të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë.</p> <p>2. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për tekstet shkollore që janë të përcaktuara me këtë ligj zbatohen edhe për tekstet shkollore dhe materialet mësimore për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë.</p> <p>3. Sipas marrëveshjes përkatëse dhe në përputhje me programin e përbashkët mësimor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, mund të shpallet konkurs i përbashkët në nivel ndërshtetëror.</p>	<p>5. Textbooks for non-majority communities also include textbooks for the Albanian language and environmental languages as elective subject.</p> <p style="text-align: center;">Article 6</p> <p style="text-align: center;">Textbooks for teaching materials for learning the Albanian language and Albanian culture in diaspora and exile</p> <p>1. The Ministry announces a competition for the drafting of textbooks for learning Albanian language and culture in the diaspora and exile.</p> <p>2. All the rules, procedures and standards for textbooks that are defined by this law also apply to textbooks and teaching materials for learning the Albanian language and Albanian culture in diaspora and exile.</p> <p>3. According to the relevant agreement and in accordance with the joint curriculum between Kosovo and Albania, a joint competition can be announced at the interstate level.</p>	<p>5. Školski udžbenici za nevećinske zajednice takođe uključuju i udžbenike za albanski jezik i jezike u toj sredini kao izborne predmete.</p> <p style="text-align: center;">Član 6</p> <p style="text-align: center;">Školski udžbenici i nastavni materijal za nastavu albanskog jezika i albanske kulture u dijaspori i izgnanstvu</p> <p>1. Ministarstvo raspisuje konkurs za izradu školskih udžbenika za nastavu albanskog jezika i kulture u dijaspori i izgnanstvu.</p> <p>2. Sva pravila, procedure i standardi za školske udžbenike koji su definisani ovim zakonom primenjuju se i za školske udžbenike i nastavne materijale za nastavu na albanskom jeziku albansku kulturu u dijaspori i izgnanstvu</p> <p>3. Prema relevantnom sporazumu i u skladu sa zajedničkim nastavnim planom Kosova i Albanije, može se raspisati zajednički konkurs na međudržavnom nivou.</p>
---	---	---

<p align="center">Neni 7 Tekstet shkollore dhe materialet mësimore digjitale</p>	<p align="center">Article 7 Textbooks and digital teaching materials</p>	<p align="center">Član 7 Školski udžbenici i digitalni nastavni materijal</p>
<p>1. Teksti shkollor digjital mund të përdoret si tekst shkollor.</p> <p>2. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për tekstin shkollor që janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen edhe për tekstin shkollor digjital.</p> <p>3. Materialet mësimore digjitale mund të përdoren si materiale themelore apo plotësuese.</p> <p>4. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për materialet mësimore që janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen edhe për materialet mësimore digjitale.</p> <p>5. Rregullat, procedurat dhe standardet që janë specifike për tekstin digjital dhe materialet mësimore digjitale rregullohen me akt nënligjor të Ministrisë.</p> <p>6. Tekstet shkollore dhe materialet mësimore digjitale të miratuara nga Ministria, publikohen në katalogun e teksteve shkollore.</p>	<p>1. The digital textbook can be used as a textbook.</p> <p>2. All rules, procedures and standards for the textbook that are defined by this law are also applied to the digital textbook.</p> <p>3. Digital teaching materials can be used as basic or supplementary materials.</p> <p>4. All rules, procedures and standards for the textbook that are defined by this law are also applied to the digital teaching materials.</p> <p>5. The rules, procedures and standards that are specific to the digital text and digital teaching materials are regulated by a sub-legal act of the Ministry.</p> <p>6. Textbooks and digital teaching materials approved by the Ministry are included in the textbook catalog.</p>	<p>1. Digitalni školski udžbenik se može koristiti kao školski udžbenik.</p> <p>2. Sva pravila , procedure standardi za školske udžbenik koji su definisani ovim zakonom primenjuju se i za digitalne školske udžbenike.</p> <p>3. Digitalni nastavni materijali mogu se koristiti kao osnovni ili dopunski.</p> <p>4. Sva pravila, procedure i standardi za nastavne materijale koji su definisani ovim zakonom primenjuju se i na digitalne nastavne materijale.</p> <p>5. Pravila, procedure i standardi koji su specifični za digitalni udžbenike i nastavne materijale uređuje se podzakonskim Ministarstva.</p> <p>6. Školski udžbenici i digitalni nastavni materijali odobreni od strane Ministarstva objavljuju se u katalogu školskih udžbenika.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 8 Mjetet shkollore</p> <p>1. Mjetet shkollore janë mjete pedagogjike në formë të pajisjeve, veglave dhe materialeve të ndryshme didaktike teknike që përkrahin arritjen e kompetencave kurrikulare tek nxënësit.</p> <p>2. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për tekste shkollore që janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen edhe për mjetet mësimore.</p> <p>3. Mjetet shkollore të miratuara nga Ministria publikohen në katalogun e teksteve shkollore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 School tools</p> <p>1. School tools are pedagogical tools in the form of equipment, tools and various didactic and technical materials that support the achievement of curricular competencies in students.</p> <p>2. All rules, procedures and standards for the textbook that are defined by this law are also applied to the digital textbook.</p> <p>3. School tools approved by the Ministry are published in the textbook catalog.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Školski pribor</p> <p>1. „Školski materijali su pedagoška sredstva u vidu opreme, alate i raznih didaktičkih i tehničkih materijala koji podržavaju ostvarivanje kurikularnih kompetencija kod učenika.</p> <p>2. Sva pravila, procedure standardi za školske udžbenik koji su definisani ovim zakonom primenjuju se i za nastavne alatie.</p> <p>3. Školski pribor odobren od strane Ministarstva objavljuje se u katalogu školskih udžbenika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Materialet, lodrat dhe pajisjet edukative për klasën parafillore</p> <p>1. Për klasën parafillore grup-mosha 5-<6) përgatiten pako të veçanta edukative, interaktive dhe multimediale të cilat përfshijnë materiale edukative dhe mjete didaktike adekuate për këtë grup-moshë për t'u mundësuar fëmijëve një zhvillim dhe edukim sa më cilësor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Educational materials, toys and equipment for the pre-primary grade</p> <p>1. For the pre-primary class group age 5-<6) special educational, interactive and multimedia packages are prepared which include educational materials and didactic tools suitable for this group age, to enable the best possible development and education of children.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Materijali, igračke i edukativni alati za predškolski razred</p> <p>1. Za predškolski razred uzrast grupe 5- <6) pripremaju se posebni edukativni, interaktivni i multimedijalni paketi koji obuhvataju edukativne materijale i didaktička sredstva pogodna za ovu starosnu grupu kako bi se deci omogućilo što kvalitetnii razvoj razvoj i edukacija.</p>

<p>2. Përgatitja e materialeve edukative bëhet në përputhje me Standardet për materiale, lodra dhe pajisje edukative për këtë grup-moshë dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Rregullat dhe procedurat për tekstet shkollore që janë të përcaktuara me këtë ligj zbatohen përshtatshëmrisht edhe për materialet, lodrat dhe pajisjet edukative për këtë grup-moshë.</p>	<p>2. The preparation of educational materials is done in accordance with Standards for educational materials, toys and equipment for this group age and in accordance with the legislation in force.</p> <p>3. The rules and procedures for textbooks that are defined by this law are also applied accordingly to educational materials, toys and equipment for this group age.</p>	<p>2. Izrada nastavnog materijala vrši se u skladu Standardi za nastavne materijale, igračke i edukativne alate ovu starosnu grupu i u skladu sa važećom zakonskom.</p> <p>3. Pravila i procedure za školske udžbenike definisane ovim zakonom shodno se primenjuju i na nastavni materijal, igračke i edukativne opreme za ovu starosnu grupu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Libri i mësimdhënësit</p> <p>1. Libri i mësimdhënësit është një udhëzues praktik për mësimdhënësit që ofron udhëzime të qarta për realizimin e përmbajtjeve mësimore, vlerësim të nxënësve si dhe këshilla të përgjithshme për planifikimin e mësimdhënies, menaxhimin e klasës, kuize e teste si dhe burime, referenca e materiale shtesë mësimore.</p> <p>2. Përmbajtja, formati dhe struktura e librit për mësimdhënësin, përcaktohet në dokumentin e standardeve për tekste shkollore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Teacher's book</p> <p>1. The teacher's book is a practical guide for teachers that provides clear instructions for the implementation of teaching content, student assessment and general tips for teaching planning, classroom management, quizzes and tests as well as resources, references and additional teaching materials.</p> <p>2. The content, format and structure of the book for the teacher is defined in the document Standards for textbooks.</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Knjiga za nastavnike</p> <p>1. „Knjiga za nastavnika“ je praktičan vodič za nastavnika koji daje jasna uputstva za realizaciju nastavnog sadržaja, ocenjivanje učenika i opšte savete za planiranje nastave, upravljanje učionicama, kvizove i testove kao i izvore, reference i dodatne nastavne materijale.</p> <p>2. Sadržaj, format i struktura knjige za nastavnika definiše se u dokumentu o Standardima za udžbenike.</p>

<p>3. Libri i mësimdhënësit promovon arsimin gjithëpërfshirës në shkollë, klasë dhe nivel individual.</p> <p>4. Libri i mësimdhënësit përgatitet nga autori ose autorët e tekstit bazë duke mos përjashtuar përfshirjen e bashkëautorëve tjerë.</p> <p>5. Libri i mësimdhënësit dorëzohet pas aprovimit të dorëshkrimit të përzgjedhur për botim nga Ministria, gjatë fazës së përgatitjes teknike.</p> <p>6. Libri i mësimdhënësit ofrohet në formë të shtypur ose elektronike.</p>	<p>3.The teacher's book promotes inclusive education at school, class and individual level.</p> <p>4.The teacher's book is prepared by the author or authors of the basic text without excluding the involvement of other co-authors.</p> <p>5.The teacher's book is handed over after the approval of the manuscript selected for publication by the Ministry, during the technical preparation phase.</p> <p>6.The teacher's book is provided in hard copy or electronically.</p>	<p>3. Knjiga za nastavnike promoviše inkluzivno obrazovanje u školi, razred i individualnom nivou.</p> <p>4. Knjigu za nastavnike priprema autor ili autori osnovnog teksta ne isključujući učešće drugih koautora.</p> <p>5. Knjiga nastavnika se predaje nakon odobrenja rukopisa odabranog za objavljivanje od strane Ministarstva, u fazi tehničke pripreme.</p> <p>6. Knjiga nastavnika dostupna je u štampanom ili elektronskom obliku.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Tekstet për gjuhë të huaja</p> <p>1. Ministria shqyrton dhe miraton tekste shkollore dhe materiale mësimore për gjuhë të huaja.</p> <p>2. Tekstet për gjuhë të huaja, të miratuara për përdorim duhet të jenë në përputhje me kurrikulën dhe legjislacionin në fuqi për tekste shkollore.</p> <p>3. Të gjitha rregullat, procedurat dhe standardet për tekstet shkollore që janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen përshtatshëmrisht për vlerësimin, përzgjedhjen, botimin dhe përdorimin e</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Textbooks for foreign languages</p> <p>1. The Ministry reviews and approves textbooks and teaching materials for foreign languages.</p> <p>2. Textbooks for foreign languages, approved for use, should be in accordance with the curriculum and legislation in force for textbooks.</p> <p>3. All rules, procedures and standards for textbooks that are defined by this law are applied appropriately for the assessment, selection, publication and use of textbooks and teaching materials for foreign languages.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Udžbenici za strane jezike</p> <p>1. Ministarstvo pregledava i odobrava školske udžbenike i nastavni materiale za strane jezike.</p> <p>2. Udžbenike za strane jezike, odobreni za upotrebu, treba da budu u skladu sa važećim kurikulumom i zakonom za školske udžbenike.</p> <p>3. Sva pravila, procedure i standardi za školske udžbenike koji su utvrđeni ovim zakonom primenjuju usklađeno za ocenjivanje, odabira, objavljivanje i i</p>

<p>teksteve shkollore dhe materialeve mësimore për gjuhë të huaja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Tekstet e përkthyer dhe përshtatura nga gjuhët e huaja</p> <p>1. Ministria miraton tekste shkollore dhe materiale mësimore të përkthyer dhe të përshtatura nga gjuhët e huaja sipas procedurave dhe kriterëve vlerësues të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të Ministrisë.</p> <p>2. Përkthimi dhe përshtatja e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore bëhet për fusha/lëndë të caktuara sipas vendimit të Ministrisë.</p> <p>3. Rregullat dhe procedurat për tekstet shkollore që janë të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen përshtatshmërisht edhe për tekstet shkollore dhe materialet mësimore të përkthyer dhe të përshtatura nga gjuhët e huaja.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 The translated and adapted textbooks from foreign languages</p> <p>1. The Ministry approves textbooks and teaching materials translated and adapted from foreign languages according to the procedures and evaluation criteria defined in this law and sub-legal acts of the Ministry.</p> <p>2. The translation and adaptation of textbooks and teaching materials is done for certain fields / subjects according to the decision of the Ministry.</p> <p>3. The rules and procedures for textbooks that are defined by this law are also applied accordingly to textbooks and teaching materials translated and adapted from foreign languages.</p>	<p>upotrebu školskih udžbenika i nastavnog materijala za strani jezik.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Udžbenici prevedeni i prilagođeni sa stranih jezika</p> <p>1. Ministarstvo odobrava školske udžbenike i nastavna materijale prevedene i prilagođene sa stranih jezika u skladu sa procedurama i kriterijumima za ocenjivanje utvrđenim ovim zakonom i podzakonskim aktima Ministarstva.</p> <p>2. Prevod i adaptacija udžbenika i nastavnog materijala vrši se za pojedine oblasti/predmete prema odluci Ministarstva.</p> <p>3. Pravila i procedure za školske udžbenike koji su definisani ovim zakonom shodno se primenjuju i na školske udžbenike i nastavne materijale prevedena i prilagođena sa stranih jezika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Lektyra shkollore</p> <p>1. Ministria formon komision profesional për përgatitjen e listës së rekomanduar për lektyrën shkollore.</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 School reading book</p> <p>1. The Ministry forms a professional commission for the preparation of the recommended list for school reading book.</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Školska lektira</p> <p>1. Ministarstvo formira stručnu komisiju za pripremu listu o preporučenim školskim lektirama</p>

<p>2. Lektyrat shkollore përcaktohen në përputhje me planin dhe programin mësimor të klasës dhe lëndës përkatëse.</p> <p>3. Lista e rekomanduar përgatitet për secilën klasë, përditësohet në mënyrë periodike, publikohet në faqen e Ministrisë dhe në Katalogun e Teksteve Shkollore.</p> <p>4. Ndalohen lektyrat shkollore që cenojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin personal dhe barazinë gjinore, ose nxisin urrejtje politike, kombëtare dhe fetare.</p>	<p>2.School reading books are defined in accordance with the curriculum of the respective class and subject.</p> <p>3.The recommended list is prepared for each class, is updated periodically and published on the Ministry's website and in the Catalog on Textbooks.</p> <p>4.School reading books that violate human rights, personal dignity and gender equality, or incite political, national and religious hatred are prohibited.</p>	<p>2. Školske lektire se definišu u skladu sa nastavnim planom i programom za dotični razred i predmet.</p> <p>3. Preporučena lista se priprema za svaki razred, periodično se ažurira i objavljuje na sajtu Ministarstva i katalogu školskih udžbenika.</p> <p>4. Zabranjene su školske lektire koje narušava ljudska prava, lično dostojanstvo i ravnopravnost polova, ili raspiruje političku, nacionalnu i versku mržnju.</p>
<p>Neni 14 Dokumentacioni pedagogjik</p>	<p>Article 14 Pedagogical documentation</p>	<p>Član 14 Pedagoška dokumentacija</p>
